



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 2268141; 2268142

Nr. 144/17 Prot.

Tiranë, më 11.07.2017

V E N D I M

Nr.156, datë 11/07/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 92, datë 25.04.2017, "Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjës ** , protokolluar me nr. 144 prot., datë 22.02.2017"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 92, datë 25.04.2017, "Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjës ***** , protokolluar me nr. 144 prot., datë 22.02.2017",

Vërejtje:

Me Urdhrin nr. 144/1 prot., datë 28.02.2017, "Për verifikimin e informacionit që përmban shkresa me nr. 144 prot., dt. 22.02.2017, për transferimin e përkohshëm në periudhën e provës dhe përfundimin e procedurave të konfirmimit si nëpunës civil", Komisioneri ka nisur verifikimin e rastit të punonjës *****. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 92, datë 25.04.2017, "Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjës ***** , protokolluar me nr. 144 prot., datë 22.02.2017", në të cilin është vendosur:

1. "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të përmbyllë procesin e konfirmimit të nëpunës ***** në përputhje me nenin 24, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe kreut VI, pika 6, e në vijim, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive":
- ✓ Eprori direkt i pozicionit "Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik", në Zyrën e Klasifikimit/Vlerësimit/Kontrollit Fizik, në Degën Doganore Tiranë (që është pozicioni i përhershëm i punonjës ***** , në administratën doganore dhe njëkohësisht edhe në shërbimin civil), të finalizojë periudhën e provës, me nxjerrjen e aktit individual përkatës, sipas përcaktimeve të kreut VI, të pikës 7, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive".

- ✓ *Vendimi i eprorit direkt, duhet t'i njoftohet nëpunëses ***** dhe njësisë përgjegjëse, DAP.*
 - ✓ *Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të kreut VI, pika 13, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, në rastin e vendimit të konfirmimit, duhet të finalizojë këtë proces nëpërmjet nxjerrjes së aktit të deklarimit të statusit të nëpunëses ***** , brenda 10 ditëve, nga data e njoftimit të konfirmimit nga institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.*
 - ✓ *Pas këtij veprimi, punonjësja të kthehet në pozicionin fillestar të punës, pasi ka përfunduar afati 6 mujor i transferimit.*
2. *Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit, si dhe nëpunësja *****.*
 3. *Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, 15 ditë.”*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar Nr. 92, datë 25.04.2017, të Komisionerit, me Urdhrin nr. 144/12 prot., datë 16.05.2017, “Për verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 92, datë 25.04.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, ka filluar verifikimin e zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Stela Ndoka dhe Helga Peti, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 22.05.2017, u paraqitën në institucion. Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 144/13 prot., datë 16.05.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në institucion komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetohin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmëruar. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit është materializuar në procesverbalin e datës 22.05.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- *Në zbatim të pikës 1 të Vendimit Nr. 92, datë 25.04.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës ***** , protokolluar me nr. 144 prot., datë 22.02.2017”, eprori direkt i nëpunëses, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, ka finalizuar periudhën e provës duke u bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë, mendimin me shkrim nga nëpunësi më i vjetër dhe, me Vendimin nr. 5439 prot., datë 05.06.2017, “Konfirmim i nëpunësit civil”, ka konfirmuar punonjësën ***** , si nëpunës civil në pozicionin Doganier Klasifikimi / Vlerësimi / Kontrolli Fizik, në Zyrën e Klasifikimit / Vlerësimit / Kontrollit Fizik, pranë Degës Doganore Tiranë - Kategoria C2.*

Për këtë vendim është vënë në dijeni nëpunësja dhe njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 15636 prot., datë 04.07.2017. Brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të konfirmimit nga institucioni, Departamenti i Administratës Publike, në përputhje me pikën 13, Kreu VI të VKM nr. 243, datë 18.03.2017, duhet të nxjerrë aktin e deklaramentit të statusit të nëpunësit (afat i cili nuk ka përfunduar akoma).

Me Urdhrin nr. 12303 prot., datë 22.05.2017, “Për rikthimin në detyrën e mëparshme”, nëpunësja *****, është rikthyer në vendin e saj të punës me detyrë Doganier Klasifikim / Vlerësim / Kontrollit Fizik në Zyrën e Klasifikimit / Vlerësimit / Kontrollit Fizik, në Degën Doganore Tiranë.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 92, datë 25.04.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****, protokolluar me nr. 144 prot., datë 22.02.2017”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 92, datë 25.04.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****, protokolluar me nr. 144 prot., datë 22.02.2017” në institucionin, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 92, datë 25.04.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****, protokolluar me nr. 144 prot., datë 22.02.2017”.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA